



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 52 datë 27.9.2022

**“PER NJE NDRYSHIM NE VKB NR. 3 DATE 05.01.2022 “PER MIRATIMIN E
BUXHETIT TE VITIT 2022 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM
PERFUNDIMTAR 2022-2024 TE BASHKISË SHKODER” I NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 27.9.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar; nenin 45 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligjin nr.115, date 25.01.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”; të ndryshuar ; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimi plotësues nr 1, date 10.01.2022 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022”, VKM nr. 789, datë 15.12.2021, ‘Për kriteret, mënyrën e shpërblyerjes dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre’, VKB nr.03 datë 05.01.2022, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, Vendimin e Kryetarit nr. 292, datë 26.05.2022 “Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave të shpenzimeve korrente brënda të njëjtit program për vitin 2022” , sipas materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të VKB nr. 3 datë 05.01.2022 , konkretisht të emërimit të fishprojektit P08130.O3.A25 në programin 08130 ‘Sport dhe Argëtim’ , si më poshtë:

Ishte

Nr	Nr. Programi	Projekti Emërtimi	Institucioni
----	--------------	-------------------	--------------

		Programi		
1	08130 (5)	Sport dhe Argëtim	P08130.O3.A25 Shpërblim për rezultatet në arenën ndërkombëtare për sportistët e trajnerët që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës	Bashkia Shkodër
			TOTALI	

Bëhet

Nr	Nr. Programi	Programi	Projekti Emërtimi	Institucioni
1	08130 (5)	Sport dhe Argëtim	P08130.O3.A25 Shpërblim për rezultatet në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare për sportistët e trajnerët që përfaqësojnë ekipet e Shkodrës.	Bashkia Shkodër
			TOTALI	

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 31 vota

Vota Pro 31

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 3.10.2022